

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 31/05/ 2001, une Regleta Panajoti gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studjova kerkesen dhe dokumentacionin e paraqitur nga z James Reiff ne cilesine e Drejtorit te Pergjithshem te Shoqerise "Partneri Shqiptar ne Mikrokredi" SHA per depozitimimin e akteve te personit juridik ne lidhje me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise,

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "Partneri Shqiptar ne Mikrokredi" SH.A eshte person juridik i se drejtes shqiptare dhe eshte regjistruar me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr 25341, date 2 mars 2001, me aksionere Roland Bagaviki, Kalia Musha, Donika Kercini, Mishel Remacka, Ariana Haxhiu, Mark Crawford, John De Lanoy Lewis dhe William Reichardt, me seli ne adresen Rruga "Gjin Bue Shpata", Nr 7/1, Tirane

Me date 28 mars 2001, eshte zhvilluar mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "Partneri Shqiptar ne Mikrokredi" SH.A, ne te cilen jane marre vendimet e meposhtme.

- Transferimi i 100 per qind te aksioneve te shoqerise "Partneri Shqiptar ne Mikrokredi" SHA tek shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe)", shoqeri e krijuar ne baze te ligjit anglez te shoqerive te vitit 1985 me numer 3516266;
- Anullimi i nenit 27.2 te Statutit te shoqerise.
- Emerimi i anetareve te rinj te Keshillit Mbikqyres te shoqerise si me poshte.
 - Roland Bagaviki
 - Donika Kercini
 - Arjana Haxhiu
 - William Reichardt
 - Richard Halmekangas
 - Ken Vander Weele
 - Michael Martin
 - Robert Baker
 - Mark Crawford
- Drejtor i Pergjithshem i shoqerise emerohet z. James Reiff.
- Ekspert Kontabel i Autorizuar i shoqerise eshte z. Limoz Malaj

Me date 26 mars 2001 eshte zhvilluar mbledhja e Drejtorise se shoqerise "Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe)" e cila ka marre vendim per zoterimin e 100 per qind te aksioneve te shoqerise "Partneri Shqiptar ne Mikrokredi" SHA duke u bere aksioner i vetem i kesaj shoqerie.

Me date 30 prill eshte lidhur kontrata per transferimin nepermjet dhurimit te aksioneve te shoqerise "Partneri Shqiptar ne Mikrokredi" SHA tek shoqeria "Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe)" e cila behet aksioner i vetem i shoqerise "Partneri Shqiptar ne Mikrokredi" SHA duke zoteruar 100 per qind te aksioneve te saj

PER KETO ARSYE:

Pas shqyrtimit te kerkeses, e cmoj ate te mbeshtetur ne ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare dhe Ligjin Nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e Kerkeses;
- Depozitimimin e Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "Partneri Shqiptar ne Mikrokredi" SHA te dates 28 mars 2001, te Vendimit te Drejtorise se shoqerise Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe) te dates 26 mars 2001 si dhe te kontrates per transferimin nepermjet dhurimit te aksioneve te shoqerise "Partneri Shqiptar ne Mikrokredi" SHA tek shoqeria Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe) te dates 30 prill 2001.
- Urdherohet zyra e Regjistrat Tregtar te beje pasqyrimin e ndryshimeve ne skeden perkatese te shoqerise.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE
R. Pajzaku